



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 dhe nenin 3 paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi c dhe 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3 dhe 5.1.9, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 03.04.2025, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**Për Emërimin e Anëtares të Kuvendit Komunal**

- I. **Znj.Vanesë Sadriu**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Ferizaj, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtares të kuvendit komunal znj.Arbnore Salihu.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Vanesë Sadriu dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 02.04.2025, Nr.04/25/814/2025, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Arbnore Salihu, e cili ka dhënë dorëheqje për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Vanesë Sadriu. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjta me numër më të madh të votave duke mos tejkalar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 03.04.2025

**Kreshnik RADONIQI**

Kryesues i KQZ





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission  
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 dhe nenin 3 paragrafi 3.2 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi c dhe 37 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3 dhe 5.1.9, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 03.04.2025, nxjerr këtë:

## VENDIM

### Për Emërimin e Anëtares të Kuvendit Komunal

- I. **Znj.Egzona Geci**, emërohet anëtare e kuvendit komunal në Skenderaj, nga subjekti politik "Lista e Pavarur Bekim Jashari", duke e zëvendësuar anëtares të kuvendit komunal znj.Sala Jashari.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Egzona Geci dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 03.04.2025, Nr.07/7-816/2025, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Sala Jashari, e cili ka dhënë dorëheqje për arsye të zgjedhjes deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Egzona Geci. Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, e gjinisë së njëjta me numër më të madh të votave duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 03.04.2025

**Kreshnik RADONIQI**

Kryesuesi i KQZ-së  
Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Prishtinë  
Priština





**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna nga nën paragrafi 1.2, paragrafi 1, nenin 18 dhe nenin 63 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në zbatim të nën paragrafi 1.2, paragrafi 1 të nenit 7 të Rregullores nr.01/2024 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, me datë 03/04/2025 merr këtë:

## V E N D I M

### **Për çregjistrim të partisë politike Partia Republikane për Ndryshime**

- I.** Miratohet rekomandimi i Zyrës për çregjistrimin dhe largimin nga regjistri i partisë politike **“Partia Republikane për Ndryshime”** për mosdorëzimin e Formularit për vazhdimin e regjistrimit.
- II.** Zyra për regjistrim certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike obligohet që të njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politik Partia Republikane për Ndryshime, për marrjen e këtij Vendimi.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

### **Arsyetim**

Në përputhje me obligimet që dalin nga neni 13, paragrafi 7 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të gjitha partitë politike të regjistruara janë të obliguara që çdo vit deri më 31 mars të dorëzojnë Formularin e vazhimit të regjistrimit. Zyra në përmbushje të obligimeve të saj, ka njoftuar të gjitha partitë politike në lidhje me obligimin e tyre për dorëzimin e Formularit për vazhdim të regjistrimit më datat 10 mars, 25 mars dhe përsëri me 28 mars 2025. Partia Politike, “Partia Republikane për Ndryshime” e regjistruar më 18 mars 2021, nuk ka përmbush obligimet e sipërpërmendura, respektivisht nuk ka dorëzuar Formularin për vazhdimin e regjistrimit të partisë. Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 03/04/2025

**Kreshnik RADONIQI**



Kryesues i KQZ

**Këshillë juridike:** Partia Republikane për Ndryshime ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa brenda pesë (5) ditë pune pas publikimit të vendimit.



**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission**  
*Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova*

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**, në pajtim me autorizimet e dhëna nga nënparagrafi 1.2, paragrafi 1, nenin 18 dhe nenin 63 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe në zbatim të nënparagrafi 1.2, paragrafi 1 të nenit 7 të Rregullores nr.01/2024 për Regjistrimin dhe Funksonimin e Partive Politike, me datë 03/04/2025 merr këtë:

## V E N D I M

### Për çregjistrim të partisë politike Shpresa Demokrate

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për çregjistrimin dhe largimin nga regjistri i partisë politike “**Shpresa Demokrate**” për mosdorëzimin e Formularit për vazhdimin e regjistrimit.
- II. Zyra për regjistrim certifikim dhe kontrollin financiar të subjekteve politike obligohet që të njoftoj përfaqësuesin e Partisë Politike Shpresa Demokrate, për marrjen e këtij Vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit

### Arsyetim

Në përputhje me obligimet që dalin nga neni 13, paragrafi 7i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, të gjitha partitë politike të regjistruara janë të obliguara që çdo vit deri më 31 mars të dorëzojnë Formularin e vazhimit të regjistrimit. Zyra në përmbushje të obligimeve të saj, ka njoftuar të gjitha partitë politike në lidhje me obligimin e tyre për dorëzimin e Formularit për vazhdim të regjistrimit më datat 10 mars, 25 mars dhe përsëri me 28 mars 2025. Partia Politike, “ Shpresa Demokrate” e regjistruar më 6 Tetor 2023, nuk ka përmbush obligimet e sipërpërmendura, respektivisht nuk ka dorëzuar Formularin për vazhdimin e regjistrimit të partisë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, 03/04/2025

**Kreshnik RADONIQI**



Kryesues i KQZ

**Këshillë juridike:** Partia Shpresa Demokrate ka të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës brenda pesë (5) ditë pune pas publikimit të vendimit.